



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 54/1 Prot.

Tiranë, më 02.02 2015

VENDIM

Nr. 11, datë 02/02/2015

Bazuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 3 dhe 5/b të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" dhe nenin 31/1/a/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, shtetasi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 54 Prot., datë 14.01.2015, me objekt "*Ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentacionit të dosjes nr.6965 Vendimi, datë 27.05.2014*" kundër Gjykatës së Apelit Tiranë.

Bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ankuesi ka kërkuar nga Autoriteti Publik/ Gjykata e Apelit Tiranë kopje të të gjithë dokumentacionit që gjendet në dosjen

Vendimi, datë 27.05.2014 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë e administruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr.Akti 5148 mbi ankimin e bërë ndaj këtij vendimi nga vetë ankuesi, si palë ndërgjyqëse në këtë proces gjyqësor.

Kërkesa për tu pajisur me informacion/dokumentacion ka të bashkëlidhur dokumentin "Dëftesë për pranimin e objekteve postare" me postë, datë 22.11.2014.

Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se, ankuesi legjitimohet në depozitimin e ankesës së saj në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit". Nga pretendimet e parashtruara në ankesë dhe provat e administruara në dosje vërehet se, nga Gjykata e Apelit Tiranë nuk është përmbushur detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" për të trajtuar kërkesën e paraqitur nga ankuesi (në cilësinë e kërkuessit ndaj autoritetit publik) brenda afatit kohor 10 ditë pune.

Ligji për të drejtën e informimit ka parashikuar shprehimisht disa veprime që duhet të kryejë autoriteti publik në rast të marrjes së një kërkesë. Paraprakisht, nëse autoriteti publik disponon informacionin e kërkuar, ai është i detyruar të trajtojë kërkesën brenda 10 ditë pune nga depozitimi i saj, e ndërsa për shkaqe të parashikuara në pikën 3 të nenit 15, të shtyjë trajtimin e saj me 5 ditë pune të tjera, duke e njoftuar menjëherë kërkuessin. Gjithashtu, autoriteti publik gjatë trajtimit të kërkesës detyrohet të vlerësojë dhënien e informacionit për kërkuessin në

përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin përcaktohet informacioni publik pa kërkesë, me nenin 17 në të cilin përcaktohen rastet e kufizimit të dhënies së informacionit/dokumentacionit si dhe nenin 77 të Kodit të Procedurës Civile në të cilën ndër të tjera parashikohet, “...lëshimi kundrejt pagesës i kopjeve dhe ekstrakteve autentike të dokumenteve të përpiluara...”. Gjithashtu, dokumentacioni i kërkuar, bazuar në nenin 15 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore”, konsiderohet veprimtari e administratës së gjykatës dhe si i tillë i nënshtrohet ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Shkelja e konstatuar në këtë rast është mostrajtim i kërkesës brenda afateve të përcaktuara, si rezultat i të cilës nuk është parashtruar informacioni i kërkuar. Në përputhje me pikën 4 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ky veprim konsiderohet “refuzim”.

Ligji ka parashikuar se, ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në përputhje me nenin 18/2/a të tij “a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë”. Në zbatim të nenit 18 pika 3, përgjegjësia për këtë kundërvajtje administrative është e koordinatorit. Për mospërbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 10 pika 1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, mos caktimi i koordinatorit nga titullari i autoritetit publik bën që përgjegjësia të mbetet mbi këtë të fundit.

Në këto kushte, kur provohet mos trajtimi i kërkesës brenda afatit të parashikuar në ligj, ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në bazë të nenit 18 pika 2 gërma “a” sanksionohet me gjobë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 5/b/ç të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenin 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”,

#### **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës nr.54 Prot, datë 14.01.2015 të ankuesit \_\_\_\_\_, kundër Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Urdhërimin e Gjykatës së Apelit Tiranë të trajtojë kërkesën dhe të vendosë në dispozicion të ankuesit \_\_\_\_\_, informacionin e kërkuar, apo të argumentojë mosdhënien e tij, sipas objektit të kërkesës datë 22.12.2014, brenda datës 10.02.2015.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë të ankohen pranë Gjykatës Administrative kompetente në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 02.02.2015.

